

Komuna e Gjakovës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Gjakovës qeveriset nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe kryetari nga ky subjekt Pal Lekaj. Kjo parti qeverisë me Gjakovën prej zgjedhjeve të vitit 2007.
2. Komuna e Gjakovës përfshin një territor prej 587 km² dhe ka gjithsej 88 fshatra¹ me 94.556 banorë.
3. Me datën 8 Maj 2013, Qeveria e Kosovës mori vendimin për iniciimin dhe zhvillimin e procedurave ligjore për themelimin e Komunës së Rogovës.² Kjo komunë do të shkëputet nga territori i Komunës së Gjakovës. Si rezultat i krijimit të komunës së Rogovës, buxheti i komunës së Gjakovës pritet të zvogëlohet për rreth 20 përqind.³
4. Kuvendi Komunal i Gjakovës përbëhet nga 42 asambleistë, prej tyre 12 vijnë nga AAK, shtatë nga AKR, pesë nga LDK, katër nga PSHDK, tre nga PDK, tre nga LDD, dy nga ish partia ORA dhe me nga një asambleist përfaqësohen IRDK, Partia Demokristiane për Integrim, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Integrim dhe Bashkim dhe Partia Liberale e Kosovës. Ekzekutivi i Gjakovës është i përbërë nga 12 Drejtori.
5. Në hulumtimin e zhvilluar nga UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012), tregohet se 59% e gjakovarëve besojnë se komuna ka kapacitete për t'i zgjidhur problemet në komunën e tyre, përderisa 19% të tjerë besojnë se ato probleme mund të zgjidhen vetëm nga pushteti qendror.⁴

¹ Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK), Popullsia sipas gjinisë, etnicitetit dhe vendbanimit, f. 31,32.

² Vendimi i Qeverisë 08/129, datë 8 Maj 2013:

http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_129-te_te_Qeverise_2013.pdf

³ Për më shumë rreth ndikimit të krijimit të komunës së re, shih raportin e GAP "Themelimi i Komunave të reja në Kosovë: Implikimet buxhetore dhe vetë-qëndrueshmëria financiare", http://www.institutigap.org/documents/24767_KomunateReja.pdf

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 42. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

6. Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009 problemet kryesore në atë kohë në këtë komunë kanë qenë, prezenca e mbeturinave, mungesa e ujit të pijes, mos kujdesja ndaj pjesës së vjetër të qytetit si dhe ndërtimet pa leje.⁵

Problemet kryesore të Komunës së Gjakovës 2013

1. **Mungesa e ujit të pijshëm në Zonën e Rekës së Keqe.** Në aspekt të shtrirjes së infrastrukturës së ujësjellësit dhe furnizimit me ujë të pijshëm, Komuna e Gjakovës nuk ka probleme të mëdha, sidomos nëse krahasohet me komunat tjera të Kosovës. Furnizimi me ujë të pijshëm në shumicën e territorit të Komunës së Gjakovës është i rregullt dhe pa ndërprerje. Përjashtim bëjnë ndërtesat e larta të cilat kanë shtypje të ulët të ujit. Megjithatë janë diku rreth 27 fshatra të rajonit të Rekës së Keqe të cilët nuk janë të lidhura në hidrosistem dhe si rezultat nuk kanë ujë të pijes. Kjo pjesë e komunës furnizohet me ujë nga burimet e ndryshme sipërfaqësore dhe bunarët. Sipas hulumtimit të UNDP-së, 68% e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik, deklarojnë se kanë furnizim të pakufizuar me ujë, në krahasim me mesataren e familjeve të Kosovës që është 42%. Rreth 12% kanë pasur ndërprerje të furnizimit me ujë për 1 deri në 4 orë në ditë, 6% prej 5 deri në 10 orë në ditë, kurse 3% kanë përvojë me ndërprerje më të gjata se 11 orë në ditë.⁶
2. **Çarshia e Vjetër.** Çarshia e Vjetër gjendet në pjesën e vjetër të qytetit. Ajo është e vjetër sa edhe vet qyteti i Gjakovës. Aty ishte qendra ekonomike e qytetit të Gjakovës. Mirëpo, me rritjen e qytetit, hapjen e fabrikave, dhe modernizimin e aktivitetit ekonomik, Çarshia e Vjetër humbi rëndësinë e saj dhe qendra ekonomike e Gjakovës ndërroi vend. Megjithatë, Çarshia e Vjetër sot është pjesë e listës së trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe pjesë shumë e rëndësishme e identitetit të qytetit. Projektet për rivitalizimin e kësaj pjese të qytetit të Gjakovës deri me tani nuk kanë treguar sukses. Në fakt shumë prej tendencave për rivitalizim dështuan, si instalimi i ndriçimit publik në mes të rrugës dhe ndalimi i qarkullimit për automjete. Projekti i fundit në vitin 2012, i cili synim final kishte rivitalizimin e kësaj pjese,

⁵ Instituti GAP. Raporti Komunal. Komuna e Gjakovës. Nëntor 2009. Fq 3. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/65551_Gjakova-raporti%20komunal.pdf

⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 40. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

kishte shumë mungesa dhe paqartësi. Pikë së pari, ky projekt nuk figuron në buxhetin komunal dhe në përgjithësi ka shumë paqartësi se prej nga financohet ky projekt. Së dyti, ky projekt synonte të ndërronte të gjitha kubëzat me “pllaka të Gllarevës”, ide kjo e cila hasi në rezistencë nga qytetarë dhe ekspertë të trashëgimisë kulturore dhe në fund u refuzua edhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS).⁷ Ky intervenim ishte vlerësuar si ndërhyrje e parregullt në trashëgiminë kulturore. Pas disa sqarimesh në mes të MKRS dhe Komunës së Gjakovës, u kuptua që ky projekt nuk kishte marrë aprovimin e Ministrisë, gjë e cila tregon mungesën e vizionit dhe planit e komunës. Ndërsa Komuna përgatiste projektin dhe priste për aprovim nga MKRS, bizneset në atë pjesë të Gjakovës pësuan dëme ekonomike.

3. Mbeturinat në lumin Krena. Lumi Krena është lumi i cili e përshkon në mes qytetin e Gjakovës. Në këtë lum derdhet një pjesë e kanalizimit të qytetit. Gjithashtu, në lum shpesh hidhen edhe mbeturina. Ky fenomen rezulton në kundërmim të lumit. Mbeturinat gjinden në pjesë të shumta të lumit, por kjo dukuri bie në sy më shumë në disa pjesë të lumit, si në pjesën duke filluar nga Hotel Pashtriku dhe duke u ngjitur kundër rrjedhës së lumit për rreth 200-300 metra. Ky problem bëhet edhe më akut duke konsideruar se në këtë pjesë ka shumë familje që jetojnë anash lumit, dhe hedhja e mbeturinave mund të rezultojë në ndotje të ambientit gjë e cila e bën shumë më të lehtë shpërndarjen e sëmundjeve të ndryshme ngjitëse. Ky shqetësim i qytetarëve të Gjakovës reflektohet edhe në studimin e UNDP, ku shihet që qytetarët e Gjakovës janë përgjithësisht më të pakënaqur se mesatarja e Kosovës në aspektin e grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave.⁸

4. Ndriçimi publik. Në aspektin e ndriçimit publik është investuar në mënyrë të konsiderueshme në krijimin e infrastrukturës në shumë lagje të Gjakovës. Megjithatë, në shumë raste vihet re që përkundër faktit që është investuar në ndriçim publik, mungon mirëmbajtja e rregullt. Vërehen shpesh llamba të cilat nuk funksionojnë apo lagje të tëra të cilat përkundër faktit që kanë infrastrukturën e ndriçimit publik nuk janë të ndriçuara, shembull rruga që të shpije te spitali i qytetit, rruga në drejtim të ETC-së, etj. Është vrenjtur shpesh edhe mungesa e ndriçimit në qendrën e qytetit. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike nga KEK/KEDS pasi që komuna nuk kishte paguar për shpenzimin e energjisë elektrike.

⁷ Gazeta Jeta Ne Kosove, *Çarshia e Shkatërruar*, 2012, <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,3771>

⁸ UNDP. *Mozaiku i Kosovës 2012*, shërbimet publike dhe autoritetet lokale në fokus, f. 40.

5. Mungesa e fushave rekreative. Gjakova ka pasur disa hapësira publike për qëllime sportive dhe rekreacioni. Këto hapësira përfshijnë hapësirën e Pallatit të Sporteve “Shani Nushi”, hapësirat tek shkolla e mesme “Kadri Kusari”, dhe disa vende me pak të popullarizuara si hapësira në oborrin e shkollës fillore “Mustafa Bakija” dhe “Zekeria Rexha”. Për momentin nuk ka asnjë hapësirë publike për qëllime sportive dhe rekreative. Hapësira tek Pallati i Sporteve “Shani Nushi” është rrënuar për arsye të ndërtimit të një salle tjetër sportive e cila do të jetë e mbyllur dhe e qasshme vetëm me pagesë. Ndërsa në hapësirat tjera publike si ajo në shkollën e mesme “Kadri Kusari” apo shkollat fillore “Mustafa Bakija” dhe “Zekeria Rexha” janë ndërtuar fusha sportive me pagesë apo janë mbyllur me qëllim që të përdoren vetëm për nevoja të shkollës.

6. Shitësit ambulant. Në Gjakovë janë të njohur ‘pazaret’ e ndryshme, ku shitësit ambulant vinin nga fshatra të ndryshme për të shitur produktet e tyre. Para disa viteve u ndërmor një iniciative për sistematizimin e të gjithë shitësve ambulante në vende të caktuara të cilat do të përmbushnin kushtet për këta shitës. Në anën tjetër, shitësit ambulant u obliguan të paguajnë një shumë simbolike për përdorimin e këtyre hapësirave të destinuara për ta. Përkundër faktit që këto hapësira ekzistojnë në Gjakovë, prapë mund të shihen shitës ambulant të cilët zënë trotuaret dhe krijojnë vështirësi në lëvizje të lirë të qytetarëve. Ndër rastet më të famshme është lokacioni në afërsi të Gjykatës Komonale të Gjakovës ku shitësit ambulant mund të gjinden për çdo ditë.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur


1. Ruajtja e objekteve në zonën e vjetër të qytetit. Kjo zonë përfshinë Xhaminë e Hadumit të vitit 1554, Mejtepin, Bibliotekën, Haremin, Hamamin, Sahat-Kullën, Medresenë, Hanin e Vjetër, Kompleksin e Teqës së Madhe si edhe urat lidhëse të qytetit mbi lumin Krena, si ajo e Tabakut dhe ura e Taliqit. Këto objekte sipas bashkëbisedueseve duhet të ruhen dhe të mirëmbahen, duke evituar mundësinë e ndërtimeve të larta në afërsi të tyre.

2. Kullat në lagjen “Dyla”. Këto kulla janë karakteristike dhe tipike që pasqyrojnë traditat ndërtuese të rajonit të Gjakovës. Gjenden në jug-lindje të këtij qytetit. Bashkëbiseduesit kanë kërkuar nga autoritetet e ardhshme të këtij qytetit që të nisin konservimin dhe promovimin e këtyre kullave me qëllim të tërheqjes së vizitorëve.

Trendet Buxhetore në Komunën e Gjakovës

Komuna e Gjakovës në vitin 2013 ka 19 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010 kjo komunë ka rritur buxhetin për 4 milion euro (27%), ndërsa viti 2012 ka shënuar buxhetin më të madh gjatë katër viteve të fundit. Më 2012 Gjakova ka pasur 2.8 milion euro të hyra vetanake, një rritje prej 16% krahasuar me vitin 2010. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm⁹ ka gjetur se borxhi për tatimin në pronë arrin 3.4 milion euro dhe inkasimi ka qenë i dobët tek taksa për ushtrim të veprimtarisë. Në total, borxhi ndaj komunës arrin gati 5 milion euro. Në anën tjetër, komuna ka shpenzuar një pjesë të madhe të buxhetit të vitit 2012 në pagesën e detyrimeve që shkojnë mbrapa deri në vitin 2008. Së fundmi, sipas Zyrës së Auditorit kjo komunë ka vazhduar të hyjë në detyrime pa fonde të sigurta gjë që mund të shkaktojë probleme të mëdha financiare.

Figure 1. Buxheti i Komunës së Gjakovës 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?qjakove/2013#/~ /qjakove>

⁹ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Gjakovës Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGJ_2012_Shqip_474681.pdf

Në bazë të grafikonit të mëposhtëm rreth ndarjeve buxhetore, shohim se kjo komunë tek kategoritë kryesore të shpenzimeve siç janë: “pagat dhe mëditjet” dhe “shpenzimet kapitale”, ka pasur një trend gradual të rritjes. Një gjë që bie në pah është se në vitin 2012, subvencionet dhe transferet kanë pasur një ngritje të theksueshme prej 334 mijë euro (24%).

Figure 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të Gjakovës 2014-2016, kjo komunë planifikon një rritje të të hyrave vetanake dhe grantit qeveritar që do të ndikojë në rritjen e buxhetit në tërësi. Nga kjo rritje pritet që më së shumti të rriten shpenzimet kapitale dhe subvencionet dhe transferet.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	18.623.969	19.152.721	19.570.430
Të hyrat vetanake	3.045.000	3.136.350	3.199.077
Grantet	15.578.969	16.016.371	16.371.353
Shpenzimet Totale	18.623.969	19.152.721	19.570.430
Pagat dhe Mëditjet	10.334.911	10.334.911	10.334.911
Mallrat dhe Shërbimet	1.552.972	1.561.910	1.618.941
Shpenzimet Komunale	723.185	735.235	735.285
Subvencionet dhe Transferet	476.000	551.000	676.000
Shpenzimet Kapitale	5.536.901	5.969.665	6.205.293

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe kampanjave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulamtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të respektueshme për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Gjakovës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj.

Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulamtive më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus), DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012) dhe Qendra Regjionale për Mjedis (Regional Environment Center)-REC (Raporti i të Gjeturave nga Hulamtimi për Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, Janar 2012). Për këtë hulamtim, GAP ka bashkëpunuar edhe me organizatën lokale Rrjetin Kosovar për Informim “Mitrovicapress”.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.